

AKTI I THEMELIMIT
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"GIORDANI AGRICULTURE" SHPK

Themeluesit qe nenshkruajne me poshte:

Mbiemri	Emri	Atesia
COPA	ERIDA	VASIP
GIORDANI	PAOLO	ANTONIO

qe ne vijim do te quhen "ORTAKE".

Sot me date 21/03/2018 me vendimin dhe me vullnetin e tyre te lire , Ortaket vendosen te themelojne shoqerine tregtare, qe do te kete formen juridike, *shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, SHPK* .

Shoqeria do te regjistrohet ne Qendren Kombetare te regjistrimit, ne perputhje me nenin 26 , 28 , e vijues te ligjit nr.9723 date 3.5.2007 " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", te ndryshuar .

Shoqeria mund te krijoje nje faqe te saj ne internet, dhe te dhenat qe i njoftohen QKR, publikohen ne kete faqe dhe u vihen ne dispozicion personave te interesuar.

I

EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1

Shoqeria do te veproje ne perputhje me legjislacionin Shqiptar, me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe me dispozitat e ketij akti e te statutit te shoqerise, me objekt sipas percaktimit te bere ne nenin 3 te ketij akti.

Neni 2

Shoqeria do te kete emertimin " GIORDANI AGRICULTURE " SHPK dhe Shoqëria e ka selinë në Kavaje - Kanaparaj, toke Are Zona Kadastrale nr.2071 , Numri i pasurise 749/15

Shoqeria mund te hape dege te saj dhe zyra perfaqesimi ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe jashte vendit me vendim te Ortakeve te shoqerise.

Neni 3

Shoqeria ka objekt aktivitetin:

- Perpunim fruta dhe perime me teknologji te ndryshme, frutave, perimeve te freskta dhe te ngrira , shitje linjash teknologjike, prodhim dhe



ambalazhim te produkteve ushqimore agro - perpunuese, shitje te lendeve te para per industrine ushqimore. Shitje me shumice dhe pakice e produkteve te prodhuara. Mbjellje shtim perpunim e shfrytezim i te gjitha llojeve te frutave e perimeve. Prodhim lengjesh nga fruta perimet. Import-Eksport, tregeti me shumice e pakice te:te te gjitha farerave te fruta perimeve; te te gjitha fidanave te fruta perimeve; te ilaceve qe luftojne semundjet e fruta perimeve; lengje te ndryshme fruta perimesh; te makinerive dhe te gjitha aksesoreve qe perdoren per prodhimin e lengjeve me fruta prodhime; si dhe te gjitha artikujve qe lejohen me ligj .

Neni 4

Shoqeria eshte Shoqeri me pergjegjesi te Kufizuar. Veprimtaria e saj do te behet ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi, si dhe dispozitave te aktit te themelimit, e te statutit te shoqerise.

Neni 5

Me vendim te tyre ortaket mund te ndryshojne regjimin juridik te shoqerise, n.q.s. ne te ardhmen krijohen premise me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar.

Ne kete rast Ortaket do te pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqerise , si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregetar ne organet kompetente shqiptare.

Neni 6

Shoqeria do te fitoje personalitetin e saj juridik ne daten kur kryhet regjistrimi I saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit (QKR).

Neni 7

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per nje afat kohe te pa caktuar.

II

KAPITALI THEMELTAR , KUOTAT

Neni 8

Kapitali I shoqerise eshte caktuar dhe perbehet nga derdhja e kontributeve te ortakeve te shoqerise.

Ne dokumentat kontabile te shoqerise do te tregohet dhe regjistrohet kapitali baze I shoqerise, detajimi i tyre si dhe te gjitha transfertat qe kane te bejne me kontributin e ortakeve .

Neni 9



Kapitali i shoqerise eshte i perbere ne shumen 100 000 leke si kapital fillestar dhe eshte i ndare ne 2 kuota qe zoteron nga ortaket.

Shumat e lekeve te derdhur per formimin e kapitalit themeltar do te vertetohen nga mandati respetiv i leshuar nga banka. Ky kapital do te derdhet nga ortaket ne perkatesine :

Ortaku : ERILDA COPA 1 kuote me vlere 50.000 leke
Ortaku : PAOLO GIORDANI 1 kuote me vlere 50.000 leke

Neni 10

Ortaket kane te drejte te rrisin kontributin e tyre ne kapitalin themeltar ose ta shtojne ate duke pranuar ortake te rij, me vendimin e marre prej tyre per kete ceshtje.

Secili ortak gezon kuoten e tij ne shoqeri, ne perpjestim me kontributin qe ka dhene ne kapital. Kapitali i regjistruar i shoqerise ndahet ndermjet ortakeve ne kuota, sipas ketij raporti.

Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te lujtshme/ te palujtshme apo te drejta).

Ortaket, kontributet ne natyre i vleresojne me marreveshje te ndersjellta me njeri tjetrin dhe i shprehin vlerat e tyre ne para.

Nese nuk mund te arrihet nje marreveshje sejcili prej ortakeve mund ti drejtohet gjykates perkatese per te ngarkuar nje ekspert vleresues, me nje vendim me efekt detyrues.

Raporti i ortakeve ose i ekspertit per vleresimin e kontributeve i dorezohet QKR, se bashku me te dhenat e tjera te kerkuara per regjistrim.

Neni 11

Kuotat e kapitalit e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet, kontributit ne kapitalin e shoqerise, shitblerjes, dhurimit, trashgimise, e ne cdo menyre tjetere te parashikuar me ligj.

III


TE ARDHURAT (FITIMI) I SHOQERISE

Neni 12

Fitimi i realizuar nga shoqeria pas pagimit te detyrimeve ligjore do ti mbetet ortakeve ne raportet e zoterimit te kuotave te kapitalit.

Shoqeria mund tu shperndaje fitime ortakeve, nese pas pagimit te dividetit, aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e saj.

Administratori (administratoreti) leshojne nje certificate te aftesise paguese qe konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividenteve



Administratoret pergjigjen para shoqerise per vertetesine e certificates se aftesise paguese.

Neni 13

Pergjegjesi personale per shperndarjet e ndaluara

Ortaket, qe kane marre nga shoqeria dividente, pergjigjen personalisht ndaj shoqerise per kthimin e dividenteve, qe u jane shperndare kur nuk eshte leshuar certifikata e aftesise paguese ose kur pavarsisht leshimit te certifikates , keta ortake kane pasur dijeni per gjendjen e paafesis paguese te shoqerise ,sipas pikes 1 te nenit 77 te ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare." ose ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishin pasur dijeni per kete gjendje.

IV

ORGANET E SHOQERISE

Neni 14

Organet drejtuese te shoqerise , jane :

- Asambleja e pergjithshme
- Administratori (Administratoret)

Asambleja e pergjithshme eshte organi me i larte vendimor i shoqerise. Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per aktivitetin e shoqerise.

Asambleja thirret sa here qe mbledhja e saj eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise, ne perputhje me nenin 83, 84 te ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare." si dhe me percaktimet e bera ne statutin e shoqerise.

Mbledhja e zakonshme e asamblese se pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit.

Neni 15

Asambleja e pergjithshme me vendim te saj emerone nje ose me shume administratore te shoqerise. Emerimi behet per nje afat prej pese vitesh, me te drejte ripertesite. Emerimi I administratorit prodhon efekte pas regjistrimit ne QKR.

Statuti vendos rregulla te pasacme per emerimin dhe detyrat e administratoreve.

Tagrat e perfaqsimet te administratorit dhe cdo ndryshim I tij (tyre) njoftohen per regjistrim prane QKR. Kompetencat e administratorit percaktohen ne statut, dhe ne aktin e emerimit te tij. (tyre).

Neni 16

Administratori i shoqerise do te jete shtetesja ERIDA COPA te ciles i caktohet per nje periudhe prej 5 vitesh ,me te drejten e ripertesites se mandatit.



Aministratori si perfaqesues i shoqerise tregtare kryen te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise , duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e pergjithshme si dhe per mbajtjen e sakte e te regullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise.

Administratori kryen regjistrime dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise sic parashikohet ne ligjin per Qendren kombetare te Regjistrimit,gjithashtu raporton perpara Asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme.

Administratori mund te shkarkohet ne cdo kohe me vendim te asamblese.

V

VLEFSHMERIA E AKTIT TE THEMELIMIT

Neni 17

Akti i themelimit eshte i vlefshem nga data e miratimit dhe nenshkrimt te tij nga ortaket e shoqerise.

VI

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Neni 18

Te gjitha mosmarreveshjet qe i perkasin aktivitetit te kesaj shoqerie do te zgjidhen nga Gjykata e rrethit gjygesor Kavaje, ku shoqeria ushtron aktivitetin e saj ose gjykata administrative Durres, sipas perkatesise se ceshtjeve.

Neni 19

Ky akt themelimi behet ne 3 kopje te cilat do te perdoren sipas kerkesave ligjore.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

ERIDA COPA

ERIDA COPA



PAOLO GIORDANI

Paolo Giordani